LIGJ
Nr.9899, datë 10.4.2008

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN "PËR EKSPOZITAT NDËRKOMBËTARE", NËNSHKRUAR NË PARIS MË 22 NËNTOR 1928 DHE SHTUAR NGA PROTOKOLLET E DATAVE 10.5.1948, 16.11.1966 E 30.11.1972, SI DHE SHTESAT E DATAVE 24.6.1982 E 31.5.1988

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Konventën "Për ekspozitat ndërkombëtare", nënshkruar në Paris më 22 nëntor 1928 dhe shtuar nga protokollet e datave 10.5.1948, 16.11.1966 e 30.11.1972, si dhe shtesat e datave 24.6.1982 e 31.5.1988.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5691, datë 29.4.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

PROTOKOLL
PËR TË NDRYSHUAR KONVENTËN E NËNSHKRUAR NË PARIS MË 22 NËNTOR 1928, NË LIDHJE ME EKSPOZITAT NDËRKOMBËTARE

Palët pjesëmarrëse në këtë Konventë,

- *duke pasur parasysh* se rregullat dhe procedurat e përcaktuara nga Konventa në lidhje me ekspozitat ndërkombëtare, nënshkruar në Paris më 22 nëntor 1928, e plotësuar dhe e ndryshuar nga protokollet e 10 majit 1948 dhe të 16 nëntorit 1966, janë provuar si të dobishme e të nevojshme për organizatorët e ekspozitave, si edhe për vendet pjesëmarrëse;

- *të dëshiruara* për t'ia përshtatur kushteve bashkëkohore rregullat dhe procedurat e sipërpërmendura, së bashku me ato që lidhen me organizimin, përgjegjëse për të siguruar zbatimin e tyre, dhe për t'i konsoliduar këto dhe dispozita të tjera në një instrument të vetëm, i cili të zëvendësojë Konventën e vitit 1928,

kanë rënë dakord si vijon.

Neni 1

Synimet e këtij protokolli janë:

a) të ndryshojë rregullat dhe procedurat në lidhje me ekspozitat ndërkombëtare;

b) të ndryshojë dispozitat në lidhje me operimet e Byrosë Ndërkombëtare të Ekspozitave.

Neni 2
Amendimet e Konventës

Konventa e vitit 1928 ndryshohet më tej nga ky protokoll në përputhje me qëllimet e shprehura në nenin 1. Teksti i Konventës, siç është amenduar, përcaktohet në shtojcën ndaj këtij

protokolli, tek i cili ajo përbën një pjesë integrale.

Neni 3

1. Ky protokoll do të mbetet i hapur për nënshkrim nga qeveritë palë të Konventës së vitit 1928 në Paris nga 30 nëntori i vitit 1972 deri më 29 nëntor 1973 dhe në vijim do të mbetet i hapur për hyrje nga ato.

2. Qeveritë palë të Konventës së vitit 1928 mund të bëhen palë të këtij protokolli me anë të:

a) nënshkrimit pa rezerva në lidhje me ratifikimin, pranimin apo miratimin;

b) nënshkrimit, duke iu nënshtruar edhe ratifikimit, pranimit apo miratimit të ndjekur nga ratifikimi, pranimi apo miratimi; ose

c) hyrjes.

3. Instrumentet e ratifikimit, pranimit, miratimit apo hyrjes do të depozitohen pranë Qeverisë së Republikës së Francës.

Neni 4

Ky protokoll do të hyjë në fuqi në datën në të cilën njëzet e nëntë shtete do të jenë bërë palë në të në përputhje me dispozitat e nenit 3[1].

Neni 5

Dispozitat e këtij protokolli nuk do të zbatohen për regjistrimin e një ekspozite për të cilën është rezervuar një datë nga Byroja Ndërkombëtare e Ekspozitave jo më vonë sesa takimi i këshillit administrativ, i cili sapo parapriu hyrjen në fuqi të këtij protokolli në përputhje me nenin 4 më lart.

Neni 6

Qeveria e Republikës së Francës do të informojë qeveritë e Palëve Kontraktuese, si dhe Byronë Ndërkombëtare të Ekspozitave mbi:

a) nënshkrimet e bëra dhe ratifikimet, miratimet, pranimet dhe hyrjet e depozituara në përputhje me nenin 3;

b) datën në të cilën ky protokoll hyn në fuqi në përputhje me nenin 4.

Neni 7

Sapo ky protokoll të hyjë në fuqi, Qeveria e Republikës së Francës do të mundësojë regjistrimin e tij në Sekretariatin e Kombeve të Bashkuara në përputhje me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit, duke qenë të autorizuar në mënyrën e duhur, kanë nënshkruar këtë protokoll.

Bërë në Paris, në tridhjetë nëntor 1972, në gjuhën frënge, në një kopje të vetme, e cila do të depozitohet pranë Qeverisë së Republikës së Francës. Qeveria franceze do t'i përcjellë kopje të certifikuara qeverive të të gjitha palëve në Konventën e vitit 1928.

SHTOJCË

[1] Ky protokoll ka hyrë në fuqi më 9 qershor 1980.

KONVENTA
NË LIDHJE ME EKSPOZITAT NDËRKOMBËTARE,
E NËNSHKRUAR NË PARIS NË 22 NËNTOR 1928,
DHE PLOTËSUAR NGA PROTOKOLLET E 10 MAJIT 1948,
16 NËNTORIT 1966, 30 NËNTORIT 1972, SI EDHE
AMENDAMENTI I 24 QERSHORIT 1982 DHE AMENDAMENTI I 31 MAJIT 1988

PJESA I
PËRKUFIZIMET DHE OBJEKTIVAT

Neni 1

1. Një ekspozitë është një shfaqje e cila, pavarësisht nga titulli i saj, ka si qëllim kryesor edukimin e publikut: ajo mund të ekspozojë mjetet që janë në dispozicion të njeriut për të plotësuar nevojat për qytetërim apo për të treguar progresin e arritur në një ose më shumë degë të përpjekjeve njerëzore ose për të treguar parashikimet për të ardhmen.

2. Një ekspozitë është ndërkombëtare kur në të marrin pjesë më shumë se një shtet.

3. Pjesëmarrësit në një ekspozitë ndërkombëtare përfshijnë nga njëra anë ekspozuesit nga shtetet të cilat janë zyrtarisht të përfaqësuara, të grupuar në seksione kombëtare, ndërsa nga ana tjetër organizatat ndërkombëtare ose ekspozuesit nga vende të cilat nuk janë zyrtarisht të përfaqësuara, e së fundmi ata që janë të autorizuar në përputhje me rregullat e ekspozitës për të kryer një veprimtari tjetër, në veçanti ata të cilëve iu janë dhënë koncesione.

Neni 2

Kjo Konventë zbatohet për të gjitha ekspozitat ndërkombëtare, përveç:

a) ekspozitave që zgjasin më pak se tri javë;

b) ekspozitave të arteve të bukura;

c) ekspozitave të një natyre kryesisht tregtare.

Çfarëdo titulli që të mund t'i jepet një ekspozite nga organizatorët e saj, kjo Konventë njeh një dallim ndërmjet ekspozitave të regjistruara dhe ekspozitave të njohura.

PJESA II
KUSHTET E PËRGJITHSHME QË RREGULLOJNË ORGANIZIMIN E EKSPOZITAVE NDËRKOMBËTARE

Neni 3

Ekspozitat ndërkombëtare që paraqesin tiparet në vijim do të jenë të përshtatshme për regjistrim nga Byroja Ndërkombëtare e Ekspozitave referuar në nenin 25 më poshtë:

a) Kohëzgjatja e tyre duhet të jetë jo më pak se gjashtë javë e as më shumë se gjashtë muaj.

b) Rregullat që rregullojnë ndërtesat e ekspozitave të përdorura nga shtetet pjesëmarrëse do të përcaktohen në rregullat e përgjithshme të ekspozitës. Në qoftë se një taksë është e pagueshme mbi një pronë sipas legjislacionit të shtetit ftues, organizatorët do të jenë përgjegjës për ta paguar atë. Vetëm shërbimet që kryhen tashmë në përputhje me rregullat e miratuara nga Byroja do të kualifikohen për rimbursim.

c) Nga data 1 janar 1995, koha e ndërmjetme mes dy ekspozitave të regjistruara do të jetë të paktën pesë vjet; ekspozita e parë mund të mbahet në vitin 1995. Byroja Ndërkombëtare e Ekspozitave, gjithsesi, mund të pranojë një datë jo më shumë se një vit përpara datës që rrjedh nga dispozita e mësipërme, që të lejojë festimin e një ngjarjeje të veçantë të një rëndësie ndërkombëtare, pa ndryshuar sidoqoftë kohën e ndërmjetme prej pesë vjetësh të përcaktuar në kalendarin origjinal.

Neni 4

A) Ekspozitat ndërkombëtare që paraqesin tiparet në vijim do të jenë të përshtatshme për njohje nga Byroja Ndërkombëtare e Ekspozitave:

1. kohëzgjatja e tyre nuk mund të jetë më pak se tri javë, e as më shumë se tre muaj;

2. ato duhet të ilustrojnë një temë të përcaktuar;

3. hapësira totale e sipërfaqes së tyre duhet të mos kalojë 25 ha;

4. ato duhet t'u japin shteteve pjesëmarrëse mjediset e ndërtuara nga organizatori pa qira, taksa, tatime dhe shpenzime të tjera nga ato që përfaqësojnë shërbimet e kryera. Hapësira më e madhe që mund t'i caktohet një shteti nuk duhet të kalojë 1000 m^2. Byroja Ndërkombëtare e Ekspozitave mund të autorizojë gjithsesi një shmangie nga kërkesa që mjediset të jepen falas pa pagesë nëse kjo justifikohet nga gjendja ekonomike dhe financiare e shtetit organizator;

5. vetëm një ekspozitë e njohur, në përputhje me këtë paragraf A, mund të mbahet ndërmjet dy ekspozitave të regjistruara;

6. vetëm një ekspozitë e regjistruar apo ekspozitë e njohur në përputhje me këtë paragraf A, mund të mbahen në të njëjtin vit.

B) Byroja Ndërkombëtare e Ekspozitave mund t'i japë gjithashtu njohje:

1. ekspozitës trevjeçare të Milanos për Artet Dekorative dhe Arkitekturën Bashkëkohore, mbi bazën e prejardhjes së saj historike, me kusht që ajo të ruajë tiparet e saj origjinale;

2. ekspozitat hortikulturore A1 të miratuara nga Shoqata Ndërkombëtare e Prodhuesve Hortikulturorë, me kusht që të ketë një kohë të ndërmjetme prej të paktën dy vjetësh mes ekspozitave të tilla në shtete të ndryshme dhe prej të paktën dhjetë vjetësh mes veprimtarish të mbajtura në të njëjtin shtet,

që duhet të mbahen në kohën e ndërmjetme mes dy ekspozitave të regjistruara.

Neni 5

Datat e hapjes dhe të mbylljes së një ekspozite dhe tiparet e saj të përgjithshme do të përcaktohen në kohën e regjistrimit apo njohjes dhe mund të ndryshohen vetëm në marrëveshje me BIE.

PJESA III
REGJISTRIMI

Neni 6

1. Qeveria e Palës Kontraktuese, në territorin e së cilës është planifikuar një ekspozitë e cila është brenda sferës së veprimit të Konventës (në vazhdim cilësuar si qeveria), do t'i dërgojë Byrosë një aplikim për regjistrim apo njohje, duke treguar ligjet, rregulloret apo masat financiare që ajo propozon të ndërmarrë për ekspozitën. Qeveria e një shteti jokontraktues, e cila dëshiron të sigurojë regjistrim apo njohje të një ekspozite, mund të aplikojë te Byroja në të njëjtën mënyrë, me kusht që ajo të marrë përsipër të veprojë në përputhje me dispozitat e Konventës të përcaktuara në pjesët I, II, III dhe IV dhe me rregulloret e nxjerra për zbatimin e tyre.

2. Aplikimi për regjistrim apo njohje do të bëhet nga qeveria përgjegjëse për marrëdhëniet ndërkombëtare të vendit në të cilin është planifikuar të mbahet (në vazhdim referuar si qeveria ftuese) edhe nëse qeveria nuk është organizatore e ekspozitës.

3. Byroja do të përcaktojë në rregullat e saj të detyrueshme periudhën maksimale për të cilën mund të rezervohet një datë për një ekspozitë dhe periudhën minimale për marrjen e një aplikimi për regjistrim apo njohje; ajo do të përcaktojë gjithashtu me hollësi dokumentet që duhet të shoqërojnë një aplikim të tillë. Ajo do të përcaktojë përmes një rregulloreje të detyrueshme shumën e kontributit për t'u paguar për kostot e shqyrtimit të aplikimit.

4. Regjistrimi apo njohja do të jepet vetëm në qoftë se ekspozita i përmbush kushtet e kësaj Konvente dhe të rregullave të përcaktuara nga Byroja.

Neni 7

1. Kur dy ose më shumë vende konkurrojnë për regjistrimin apo njohjen e një ekspozite dhe nuk mund të arrijnë një marrëveshje për këtë, ato do t'i kërkojnë Asamblesë së Përgjithshme të Byrosë që të ushtrojë arbitrazh. Në marrjen e vendimit të saj, Asambleja e Përgjithshme do të marrë parasysh konsideratat e parashtruara dhe, në veçanti, çfarëdo arsyesh të posaçme të një natyre historike apo etike, periudhën që ka kaluar që nga ekspozita e fundit, si edhe numrin e shfaqjeve të organizuara nga vendet konkurruese.

2. Vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, Byroja do t'i japë përparësi një ekspozite të organizuar në territorin e një Pale Kontraktuese.

Neni 8

Një shtet, të cilit i është dhënë regjistrimi apo njohja e një ekspozite, do t'i humbë të gjitha të drejtat që rrjedhin nga regjistrimi apo njohja nëse ai e ndryshon datën e rezervuar për ekspozitë, me përjashtim të rrethanave të parashikuara në paragrafin 28 (d). Nëse ai dëshiron të organizojë ekspozitën në një datë tjetër, qeveria e interesuar do të bëjë një aplikim rishtas dhe nëse është e nevojshme, t'ia parashtrojë procedurës së përcaktuar në nenin 7 për të zgjidhur kërkesat konkurruese.

Neni 9

1. Në rast të çdo ekspozite e cila nuk është regjistruar apo njohur, Palët Kontraktuese do të refuzojnë pjesëmarrjen e tyre dhe mbështetjen e tyre, si edhe çdo financim nga qeveria.

2. Palët Kontraktuese janë të lira që të mos marrin pjesë në një ekspozitë e cila është regjistruar apo njohur.

3. Secila Qeveri Kontraktuese do të përdorë çfarëdo mjeti që ajo vlerëson të përshtatshme sipas legjislacionit të saj për të vepruar kundër organizatorëve të ekspozitave të rreme apo të ekspozitave, në të cilat pjesëmarrësit mund të tërhiqen në mënyrë të rreme nga premtime, njoftime apo lajmërime mashtruese.

PJESA IV
DETYRIMET E ORGANIZATORËVE TË EKSPOZITAVE TË REGJISTRUARA DHE TË SHTETEVE PJESËMARRËSE

Neni 10

1. Qeveria ftuese do të sigurojë që dispozitat e kësaj Konvente dhe të rregulloreve të bëra për zbatimin e tyre të respektohen.

2. Në rast se qeveria në fjalë nuk e organizon vetë ekspozitën, ajo do t'i njohë zyrtarisht organizatorët për këtë qëllim dhe do të garantojë plotësimin e detyrimeve të organizatorëve.

Neni 11

1. Të gjitha ftesat për pjesëmarrje në një ekspozitë, qofshin të drejtuara ndaj shteteve anëtare apo ndaj shteteve joanëtare, do të dërgohen përmes kanaleve diplomatike nga qeveria e vendit organizator për qeverinë e vendit të ftuar për atë shtet dhe për palët e tjera në atë shtet që janë për t'u ftuar. Përgjigjet do të përcillen përmes të njëjtave kanale, ashtu si edhe çdo kërkesë nga palë të paftuara që ato të marrin pjesë. Ftesat do të respektojnë intervalet e parashikuara nga Byroja dhe do të deklarojnë se ekspozita në fjalë është regjistruar. Ftesat ndaj organizatave ndërkombëtare do t'u dërgohen atyre drejtpërdrejt.

2. Asnjë Palë Kontraktuese nuk do të organizojë apo sponsorizojë pjesëmarrje në një ekspozitë ndërkombëtare, nëse ftesat e lartpërmendura nuk janë dërguar në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente.

3. Palët Kontraktuese marrin përsipër që as të mos dërgojnë, dhe as të mos pranojnë ftesa për të marrë pjesë në një ekspozitë qoftë në territorin e një Pale Kontraktuese, apo të një shteti joanëtar, në

rast se një ftesë e tillë nuk citon një regjistrim apo njohje të miratuar në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente.

4. Cilado Palë Kontraktuese mund të kërkojë që organizatorët të mos u dërgojnë ftesa subjekteve në territorin e saj përveç vetë asaj. Ajo, gjithashtu, mund të ndërpresë përcjelljen e ftesave apo kërkesave për të marrë pjesë nga palë të cilat nuk janë ftuar.

Neni 12

Qeveria ftuese do të caktojë një Komisioner të Përgjithshëm të Ekspozitës në rastin e një ekspozite të regjistruar apo një Komisioner të Ekspozitës në rastin e një ekspozite të njohur, i cili do të autorizohet të përfaqësojë qeverinë për të gjitha qëllimet në lidhje me Konventën dhe në të gjitha çështjet që lidhen me ekspozitën.

Neni 13

Qeveria e cilitdo vend që merr pjesë në një ekspozitë do të emërojë një Komisioner të Përgjithshëm të Seksionit në rastin e një ekspozite të regjistruar ose një Komisioner Seksioni në rastin e një ekspozite të njohur për t'ia paraqitur atë qeverisë ftuese. Komisioneri i Përgjithshëm i Seksionit ose Komisioneri i Seksionit do të ketë përgjegjësinë e vetme për organizimin e ekspozitës së vendit të tij. Ai do të informojë Komisionerin e Përgjithshëm të Ekspozitës ose Komisionerin e Ekspozitës mbi përmbajtjen e kësaj ekspozite dhe do të mbikëqyrë që të respektohen të drejtat dhe detyrimet e ekspozuesve.

Neni 14
(I shfuqizuar)

Neni 15
(I shfuqizuar)

Neni 16

Rregullat e doganave për ekspozitat ndërkombëtare do të jenë ato të përcaktuara në shtojcë, e cila përbën pjesë integrale të kësaj Konvente.

Neni 17

Në një ekspozitë vetëm seksionet e ngritura nën autoritetin e Komisionerëve të Përgjithshëm ose të Komisionerëve të emëruar në përputhje me nenin 13 nga qeveritë e vendeve pjesëmarrëse, do të quhen si kombëtare dhe si rrjedhim do të kenë të drejtë të mbajnë këtë emër. Një seksion kombëtar përfshin të gjithë ekspozuesit e vendit në fjalë, por jo mbajtësit e koncesioneve.

Neni 18

1. Në një ekspozitë, një pjesëmarrës apo një grup pjesëmarrësish mund të përdorin një titull gjeografik në lidhje me një palë pjesëmarrëse vetëm me autorizimin e Komisionerit të Përgjithshëm të Seksionit apo të Komisionerit të Seksionit të Qeverisë së Palës së interesuar.

2. Nëse një Palë Kontraktuese nuk merr pjesë në një ekspozitë, Komisioneri i Përgjithshëm apo Komisioneri i ekspozitës do të ndalojë këtë përdorim, siç parashikohet në paragrafin paraardhës në emër të Palës Kontraktuese.

Neni 19

1. Çfarëdo gjëje që ekspozohet në një seksion kombëtar duhet të ketë një lidhje të ngushtë me vendin që e ekspozon atë (për shembull, artikuj që e kanë origjinën në territorin e qeverisë pjesëmarrëse apo artikuj të krijuar nga shtetasit e vendit).

2. Me autorizimin e Komisionerëve të Përgjithshëm apo të Komisionerëve të shteteve të tjera të interesuara, artikuj apo produkte të tjera mund të paraqiten me kusht që ato të shërbejnë vetëm për

të plotësuar ekspozitën.

3. Në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet qeverive pjesëmarrëse në lidhje me paragrafët 1 dhe 2 më lart, çështja do t'i referohet kolegjit të Komisionerëve të Përgjithshëm të Seksionit apo Komisionerëve të cilët do të vendosin me shumicë të thjeshtë të atyre që janë të pranishëm. Vendimi i tyre është përfundimtar.

Neni 20

1. Përveçse kur ka dispozita që parashikojnë të kundërtën në ligjet e vendit organizator, asnjë monopol i asnjë lloji nuk do të jepet në një ekspozitë. Sidoqoftë, një monopol për një shërbim të zakonshëm mund të autorizohet nga Byroja në çdo kohë të regjistrimit apo njohjes. Në këtë rast, kushtet në vijim do të respektohen nga organizatorët:

a) ekzistenca e një monopoli apo e disa monopoleve të tilla do të tregohet në rregulloret e ekspozitës dhe në kontratën e pjesëmarrjes;

b) shërbimet që i nënshtrohen monopolit do të jenë të disponueshme për ekspozuesit sipas kushteve normale që ekzistojnë në atë shtet;

c) fuqitë e Komisionerëve të Përgjithshëm apo të Komisionerëve në seksionet e tyre përkatëse nuk do t'i nënshtrohen në asnjë rast kufizimeve të çfarëdo lloji.

2. Komisioneri i Përgjithshëm apo Komisioneri i ekspozitës do të ndërmarrë të gjitha hapat për të siguruar që tarifat për qeveritë pjesëmarrëse të mos jenë më të larta se ato për organizatorët e ekspozitës apo në çdo rast më të larta se tarifat vendore normale.

Neni 21

Komisioneri i Përgjithshëm apo Komisioneri i Ekspozitës do të bëjë gjithçka që është në fuqinë e tij për të siguruar funksionimin e duhur dhe efikas të shërbimeve publike të dobishme brenda zonës së ekspozitës.

Neni 22

Qeveria ftuese do të bëjë çdo përpjekje për të lehtësuar pjesëmarrjen e qeverive dhe shtetasve të tyre, sidomos në lidhje me tarifat e transportit dhe kushtet e pranimit të personave dhe gjërave.

Neni 23

1. Rregullat e përgjithshme të një ekspozite do të përcaktojnë nëse do të jepen apo jo çmime ndaj pjesëmarrësve, pavarësisht nga certifikatat e pjesëmarrjes, të cilat mund të jepen në çdo rast. Nëse çmimet do të jepen, dhënia e tyre mund të kufizohet në disa kategori të caktuara.

2. Nëse pjesëmarrësit nuk dëshirojnë të konkurrojnë për çmime, ata duhet të bëjnë një deklarim për këtë përpara hapjes së ekspozitës.

Neni 24

Byroja Ndërkombëtare e Ekspozitave, siç përcaktohet në nenin në vijim, do të hartojë rregulla për të përcaktuar kushtet e përgjithshme për përbërjen dhe funksionimin e jurive dhe për të vendosur se si do të jepen çmimet.

PJESA V
KOORDINIMET INSTITUCIONALE

Neni 25

1. Byroja Ndërkombëtare e Ekspozitave është ngritur për të mbikëqyrur dhe siguruar zbatimin e kësaj Konvente. Anëtarët e saj do të jenë Qeveritë e Palëve Kontraktuese. Selia e Byrosë do të jetë në Paris.

2. Byroja do të ketë natyrë juridike. Në veçanti, ajo do të ketë kompetencën për të kontraktuar, përftuar dhe disponuar pronësi të luajtshme e të paluajtshme dhe për të marrë pjesë në procedimet

ligjore.

3. Byroja do të ketë të drejtë të përfundojë marrëveshje me shtetet dhe organizatat ndërkombëtare në lidhje me privilegje dhe imunitete të tilla siç janë të nevojshme për ushtrimin e funksioneve që i janë besuar nga kjo Konventë.

4. Byroja do të përfshijë një asamble të përgjithshme, një president, një komitet ekzekutiv, komitete të specializuara, aq zëvendëspresidentë sa ka edhe komitete dhe një sekretariat nën autoritetin e një sekretari të përgjithshëm.

Neni 26

Asambleja e Përgjithshme e Byrosë do të përbëhet nga delegatë të emëruar nga Palët Kontraktuese në masën nga një deri në tre delegatë për çdo vend.

Neni 27

Asambleja e Përgjithshme do të mbajë takime të rregullta dhe mund të mbajë edhe takime të jashtëzakonshme. Ajo do të vendosë mbi të gjitha çështjet të cilat sipas kësaj Konvente janë brenda kompetencave të Byrosë e për të cilat ajo është autoriteti më i lartë. Veçanërisht, Asambleja e Përgjithshme:

a) do të diskutojë, do të adoptojë dhe do të publikojë rregullore në lidhje me regjistrimin ose njohjen, klasifikimin dhe organizimin e ekspozitave ndërkombëtare dhe për funksionimin e duhur të Byrosë. Brenda hapësirave të dispozitave të kësaj Konvente, Asambleja e Përgjithshme mund të miratojë rregulla të detyrueshme dhe gjithashtu rregullore model për të shërbyer si udhëzues për organizatorët e ekspozitave;

b) do të hartojë buxhetin, do të kontrollojë e do të miratojë llogaritë e Byrosë;

c) do të miratojë raportet e Sekretarit të Përgjithshëm;

d) do të ngrejë komitete sipas nevojës dhe do të emërojë anëtarët e Komitetit Ekzekutiv dhe të komiteteve të tjera;

e) do të miratojë çfarëdo marrëveshje ndërkombëtare të hyra në fuqi në përputhje me nenin 25(3) këtu;

f) do të adoptojë projektamendamente në përputhje me nenin 33;

g) do të emërojë Sekretarin e Përgjithshëm.

Neni 28

1. Qeveria e secilës Palë Kontraktuese, pavarësisht nga numri i delegatëve, do të ketë një votë në Asamblenë e Përgjithshme. Kjo e drejtë vote do të pezullohet nëse shuma e kontributeve që një Qeveri Kontraktuese i detyrohet sipas nenit 32 të kësaj Konvente, tejkalon shumën e kontributeve që duhet të paguajë ajo për vitin në vazhdim dhe për vitin paraardhës.

2. Asambleja e Përgjithshme do të jetë e aftë të ushtrojë funksionet e veta kur numri i shteteve anëtare të përfaqësuara është të paktën dy të tretat e shteteve anëtare që kanë të drejtë vote. Nëse nuk arrihet një kuorum i tillë, Asambleja e Përgjithshme do të mblidhet sërish me të njëjtin program pas një intervali prej të paktën një muaji. Në këtë rast, kuorumi i kërkuar do të pakësohet në gjysmën e numrit të Palëve Kontraktuese që kanë të drejtë vote.

3. Vendimet do të merren me një shumicë të delegacioneve të pranishme që votojnë në favor apo kundër, përveç kur kërkohet një shumicë prej dy të tretave në rastet në vijim:

a) miratimi i propozimeve për amendamente në këtë Konventë;

b) hartimin dhe ndryshimin e rregulloreve;

c) miratimin e buxhetit dhe të shumës së kontributeve vjetore të Palëve Kontraktuese;

d) autorizimin për një ndryshim të datave të hapjes dhe mbylljes së një ekspozite në përputhje me nenin 5 më lart;

e) regjistrimin dhe njohjen e një ekspozite në territorin e një shteti joanëtar, i cili është në konkurrim me një ekspozitë në territorin e një Pale Kontraktuese;

f) pakësimin e intervaleve të përcaktuara në nenin 3 të kësaj Konvente;

g) pranimin e vërejtjeve ndaj një amendamenti të paraqitur nga një Palë Kontraktuese; një

amendament i tillë i miratuar në përputhje me nenin 33, nga një shumicë prej katër të pestash apo me unanimitet sipas rastit;

h) miratimin e çdo projektmarrëveshjeje ndërkombëtare;

i) emërimin e Sekretarit të Përgjithshëm.

Neni 29

1. Presidenti do të zgjidhet me votim të fshehtë të Asamblesë së Përgjithshme për një periudhë prej dy vjetësh midis delegatëve të qeverive të Palëve Kontraktuese. Ai mund të mos përfaqësojë shtetin të cilit i përket gjatë periudhës së tij në detyrë. Ai mund të rizgjidhet.

2. Presidenti do të thërrasë dhe kryesojë mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme dhe do të sigurojë funksionimin e duhur të Byrosë. Në mungesë të presidentit, funksionet e tij do të ushtrohen nga zëvendëspresidenti në ngarkim të Komitetit Ekzekutiv ose, në rast të pamundësisë së tij, njëri nga zëvendëspresidentët e tjerë sipas rendit të zgjedhjes së tyre.

3. Zëvendëspresidentët do të zgjidhen midis delegatëve të Palëve Kontraktuese nga Asambleja e Përgjithshme, e cila do të përcaktojë natyrën dhe kohëzgjatjen e qëndrimit në detyrë dhe në veçanti komitetet nga të cilat ata do të caktohen.

Neni 30

1. Komiteti Ekzekutiv do të përbëhet nga delegatë të dymbëdhjetë Palëve Kontraktuese, duke emëruar secili nga një përfaqësues.

2. Komiteti Ekzekutiv:

a) do të përcaktojë dhe do të mbajë të përditësuar një klasifikim të përpjekjeve njerëzore siç mund të tregohet në një ekspozitë;

b) do të shqyrtojë të gjitha aplikimet për regjistrim ose njohje të një ekspozite dhe do t'i paraqesë ato me një informacion për miratimin nga Asambleja e Përgjithshme;

c) do të kryejë detyra të tilla siç i janë dhënë atij nga Asambleja e Përgjithshme;

d) mund të kërkojë mendimin e komiteteve të tjera.

Neni 31

1. Sekretari i Përgjithshëm, i cili do të emërohet në përputhje me dispozitat e nenit 28 të kësaj Konvente, do të jetë shtetas i vendit të njërës nga Palët Kontraktuese.

2. Sekretari i Përgjithshëm do të jetë përgjegjës për ndjekjen e veprimtarisë aktuale të Byrosë në përputhje me udhëzimet e Asamblesë së Përgjithshme dhe të Komitetit Ekzekutiv. Ai do të hartojë një projektbuxhet, do të paraqesë llogaritë dhe do të dorëzojë raporte mbi veprimtaritë e tij përpara Asamblesë së Përgjithshme. Ai do të përfaqësojë Byronë, sidomos në çështjet ligjore.

3. Asambleja e Përgjithshme do të vendosë detyrat dhe përgjegjësitë e tjera të Sekretarit të Përgjithshëm, si edhe kushtet e punës.

Neni 32

Buxheti vjetor i Byrosë do të miratohet nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me dispozitat e paragrafit 3 të nenit 28. Buxheti do të marrë parasysh rezervat financiare të Byrosë, të të ardhurave të të gjitha llojeve dhe gjithashtu, të bilancit të debiteve dhe krediteve të mbartura nga vite të mëparshme financiare. Shpenzimet e Byrosë do të përballohen nga këto burime dhe nga kontributet e Palëve Kontraktuese të llogaritura sipas numrit të pjesëve që i takon secilës Palë në përputhje me vendimet e Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 33

1. Cilado Qeveri Kontraktuese mund të bëjë një propozim për ndryshime të Konventës. Teksti i propozimit në fjalë dhe arsyet për këtë do t'i komunikohen Sekretarit të Përgjithshëm, i cili do t'ia transmetojë ato sa më shpejt që të jetë e mundur Qeverive të tjera Kontraktuese.

2. Propozimi për ndryshime mund të përfshihet në programin e një sesioni të zakonshëm apo të një sesioni të jashtëzakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme për t'u mbajtur të paktën tre muaj pas datës së dërgimit të tij nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Çdo propozim për ndryshim i miratuar nga Asambleja e Përgjithshme, në përputhje me dispozitat e paragrafit paraardhës dhe të nenit 28, do të paraqiten nga Qeveria e Republikës së Francës për pranim nga të gjitha qeveritë palë në këtë Konventë. Ai do të hyjë në fuqi për të gjitha palët në datën në të cilën katër të pestat e tyre kanë njoftuar pranimin e tyre te Qeveria e Republikës së Francës, përveçse kur një propozim për ndryshimin e këtij paragrafi, të nenit 16, ose të shtojcës referuar në atë nen nuk do të hyjnë në fuqi derisa të gjitha palët të kenë njoftuar pranimin e tyre te Qeveria e Republikës së Francës.

4. Cilado qeveri, e cila dëshiron të paraqesë një rezervim ndaj pranimit të saj për një ndryshim, do të informojë Byronë mbi termat e kësaj rezerve të propozuar. Asambleja e Përgjithshme do të japë një vendim në lidhje me pranueshmërinë e kësaj rezerve. Ajo do të lejojë gjithashtu, rezerva të cilat janë të favorshme për mbrojtjen e qëndrimeve tashmë të caktuara në lidhje me ekspozitat ndërkombëtare dhe do të hedhë poshtë ato që do të kenë efektin e krijimit të qëndrimeve të privilegjuara. Nëse rezerva pranohet, Pala e cila e ka paraqitur atë do të përfshihet mes atyre palëve të cilat mendohen ta kenë pranuar ndryshimin për qëllime të llogaritjes së shumicës së katër të pestave. Nëse ai hidhet poshtë, Qeveria e cila ka paraqitur rezervën do të zgjedhë ndërmjet refuzimit për të pranuar ndryshimin dhe pranimin e tij pa rezerva.

5. Kur ndryshimi hyn në fuqi, në rrethanat e përcaktuara në paragrafin e tretë të këtij neni, cilado Palë Kontraktuese e cila kishte refuzuar ta pranonte atë, nëse e sheh me vend, mund të përfitojë nga dispozitat e nenit 37 më poshtë.

Neni 34

1. Çdo mosmarrëveshje, ndërmjet dy ose më shumë Qeverive Kontraktuese në lidhje me zbatimin apo interpretimin e kësaj Konvente, e cila nuk mund të zgjidhet nga autoritetet e veshura me pushtetin e vendimmarrjes në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, do të jetë subjekt negociatash ndërmjet palëve në konflikt.

2. Në rast se këto negociata nuk çojnë drejt një marrëveshjeje brenda një harku kohor të shkurtër, secila palë do t'ia referojë çështjen Presidentit të Byrosë dhe do t'i kërkojë atij që të emërojë një ndërmjetës. Nëse ndërmjetësi është i paaftë të arrijë marrëveshjen e palëve në konflikt mbi një zgjidhje, ai do të mbajë shënim dhe do të përcaktojë natyrën dhe shtrirjen e konfliktit në raportin e tij për Presidentin.

3. Sapo të njoftohet në këtë mënyrë mungesa e marrëveshjes, konflikti i nënshtrohet arbitrazhit. Me këtë qëllim, cilado palë, brenda një periudhe prej dy muajsh nga data në të cilën raporti i është komunikuar palëve në konflikt, do t'i drejtojë Sekretarit të Përgjithshëm të Byrosë një kërkesë për arbitrim, duke përmendur emrin e një arbitruesi të zgjedhur nga ajo palë. Pala tjetër apo palët e tjera në konflikt duhet të përmendin secila emrin e arbitruesve të tyre përkatës, brenda një intervali prej dy muajsh. Në mungesë të kësaj, secila palë do të njoftojë Presidentin e Gjykatës Ndërkombëtare e Drejtësisë, duke i kërkuar atij që të caktojë arbitruesin apo arbitruesit. Kur disa palë veprojnë njëzëri për qëllimet e përmendura në paragrafin paraardhës, ato do të llogariten si një subjekt. Në rast dyshimi, vendimi merret nga Sekretari i Përgjithshëm. Arbitruesit do të emërojnë nga ana e tyre një arbitrues shtesë. Nëse arbitruesit nuk mund të bien dakord mbi këtë zgjedhje brenda një harku kohor prej dy muajsh, Presidenti i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, pasi është njoftuar nga secila prej palëve, do të jetë përgjegjës për emërimin e arbitruesit shtesë.

4. Trupi arbitrues do të japë vendimin e tij me shumicë të votave të anëtarëve të tij, ku arbitruesi shtesë ka të drejtën e votës vendimtare, në rastin kur votat e arbitruesve janë të ndara në mënyrë të barabartë. Ky vendim do të jetë detyrues mbi të gjitha palët në konflikt, përfundimtar dhe pa të drejtë ankimimi.

5. Cilido shtet në kohën e nënshkrimit apo ratifikimit të kësaj Konvente, apo gjatë hyrjes në të, mund ta deklarojë veten si të padetyruar nga dispozitat e paragrafëve të mësipërm 3 dhe 4. Palët e tjera Kontraktuese nuk do të jenë të detyruara përsa i përket këtyre dispozitave ndaj cilitdo shtet, i cili ka paraqitur në këtë mënyrë rezerva për qëndrimet e tij.

6. Cilado Palë Kontraktuese, e cila ka rezervuar qëndrimin e saj në përputhje me dispozitat e

paragrafit të mësipërm, në çdo kohë mund të tërheqë rezervat e saj me anë të një njoftimi drejtuar qeverisë depozituese.

Neni 35

Kjo Konventë do të jetë e hapur për nënshkrim nga çdo shtet që është anëtar i Kombeve të Bashkuara ose çdo shtet i cili nuk është një anëtar i Kombeve të Bashkuara, por që është palë në Statutin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë apo cilido shtet që është anëtar i njërës nga agjencitë e specializuara të Kombeve të Bashkuara apo i Agjencisë Ndërkombëtare për Energjinë Bërthamore dhe gjithashtu nga çdo shtet, aplikimi për hyrje i të cilit miratohet me një shumicë prej dy të tretat e Palëve Kontraktuese të cilat kanë të drejtë vote në Asamblenë e Përgjithshme të Byrosë. Instrumentet për hyrje do të depozitohen pranë Qeverisë së Republikës së Francës dhe do të hyjnë në fuqi në ditën kur ato janë depozituar.

Neni 36

Qeveria e Republikës së Francës do të informojë qeveritë nënshkruese dhe aderuese, si edhe Byronë Ndërkombëtare të Ekspozitave mbi:

a) hyrjen në fuqi të amendamenteve në përputhje me nenin 33;

b) hyrjen në përputhje me nenin 35;

c) denoncimet në përputhje me nenin 37;

d) rezervat e depozituara në përputhje me nenin 34 paragrafi 5;

e) përfundimin e kësaj Konvente, nëse do të ishte i tillë rasti.

Neni 37

1. Cilado Qeveri Kontraktuese mund ta denoncojë këtë Konventë duke njoftuar Qeverinë e Republikës së Francës me shkrim.

2. Një denoncim i tillë do të hyjë në fuqi një vit pas datës së marrjes së një njoftimi të tillë.

3. Kjo Konventë do të përfundohet nëse, si rrjedhim i denoncimeve, numri i Qeverive Kontraktuese pakësohet në më pak se shtatë. Në varësi të çfarëdo marrëveshjeje e cila mund të përfundohet ndërmjet Qeverive Kontraktuese në lidhje me shpërbërjen e Byrosë, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për çështjet që lidhen me likuidimin. Përveç kur Asambleja e Përgjithshme vendos ndryshe, sendet pasurore do të ndahen ndërmjet Qeverive Kontraktuese në përpjesëtim me kontributet e paguara që kur ato janë bërë Palë të kësaj Konvente. Nëse ka detyrime, këto do të merren të gjitha përsipër nga të njëjtat qeveri në përpjesëtim me kontributet e përcaktuara për vitin financiar në vazhdim.

Bërë në Paris, në 30 nëntor, 1972.

ANEKS I
I KONVENTËS SË NËNSHKRUAR NË PARIS MË 22 NËNTOR 1928, NË LIDHJE ME EKSPOZITAT NDËRKOMBËTARE, SIÇ ËSHTË NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR NGA PROTOKOLLET E 10 MAJIT 1948, 16 NËNTORIT 1966, 30 NËNTORIT 1972 DHE NDRYSHIMIT TË 24 QERSHORIT 1982

RREGULLORET E DOGANËS
PËR IMPORTIMIN E ARTIKUJVE NGA PJESËMARRËSIT NË EKSPOZITA NDËRKOMBËTARE

Neni 1
Përkufizime

Për zbatimin e këtij aneksi duhet të zbatohen interpretimet që vijojnë:

a) “Detyrime importi” nënkuptojnë detyrimet doganore dhe të gjitha detyrimet e taksat e tjera të pagueshme për ose në lidhje me importin dhe përfshijnë të gjitha detyrimet dhe taksat e brendshme

jo të drejtpërdrejta të vëna mbi mallrat e importit, por nuk do të përfshijnë tarifat dhe pagesat, të cilat janë të kufizuara në shumën e përafërt të kostove të shërbimit të kryera dhe nuk përfaqësojnë një mbrojtje të tërthortë të prodhimeve vendase ose një taksim të importeve për qëllime fiskale.

b) "Pranim i përkohshëm" nënkupton importimin e përkohshëm pa detyrime importi dhe pa ndalime e kufizime importi, subjekt i rieksportimit.

Neni 2

Pranimi i përkohshëm duhet të jepet për:

a) Mallra të destinuara për paraqitje ose demonstrim në ekspozitë;

b) Mallra të destinuara për përdorim në lidhje me paraqitjen e ekspozitave të huaja në ekspozitë, duke përfshirë:

I) Mallra të nevojshme për qëllimin e demonstrimit të makinerive ose aparaturave të huaja që duhet të paraqiten;

II) Materialet e ndërtimit, qoftë edhe të papërpunuara, materiale dhe pajisje dekorimi, si dhe pajisje elektrike për pavijonet e huaja dhe stendat në ekspozitë, si dhe për vendet a mjediset e caktuara në seksionin e Komisionerit të Përgjithshëm të një shteti të huaj pjesëmarrës;

III) Pajisje veglash të përdorura në ndërtim dhe mjetet e transportit, të nevojshme për punën e ekspozitës;

IV) Reklama ose material demonstrativ, i cili është në mënyrë të dukshme, material publiciteti për mallrat e huaja të paraqitura në ekspozitë p.sh.: regjistrime zanore, filma dhe pamje filmash, si dhe aparatet për përdorimin e nevojshëm të lidhur me to;

c) Pajisje që përfshijnë aparatet e interpretimit, aparatet e regjistrimit të zërit dhe filmat e karakterit edukativ, shkencor e kulturor, të destinuara për t'u përdorur për qëllimet e ekspozitës.

Neni 3

Lehtësitë e përmendura në paragrafin 2 të këtij aneksi do të jepen, me kusht që:

a) mallrat të jenë të disponueshme për identifikim gjatë rieksportimit;

b) seksioni i Komisionerit të Përgjithshëm të shtetit pjesëmarrës, pa iu kërkuar që të paguajë një depozitë, të garantojë pagesën e detyrimeve të importit për të cilat mallrat janë përgjegjëse në rastin e mosrieksportimit brenda periudhës së përshkruar pas mbylljes së ekspozitës; të tjera garanci të siguruara nga ligjet e vendit ftues mund të pranohen me kërkesën e ekspozuesve (p.sh. ATA "carnet" e inauguruar me anë të Konventës së Këshillit të Bashkëpunimit Doganor të 6 dhjetorit 1961);

c) autoritet doganore të vendit të importimit të përkohshëm të jenë të bindura se do të përmbushen kushtet e këtij aneksi.

Neni 4

Përveçse kur legjislacioni kombëtar dhe rregulloret e vendit të importimit të përkohshëm e lejojnë, mallrat të cilave iu është dhënë pranim i përkohshëm nuk do të jepen me qira, ndërsa ata u nënshtrohen lehtësive të dhëna në këtë shtesë, ose përdoren në ndonjë mënyrë për punësim ose shpërblim ose zhvendosen nga vendi i ekspozitës. Ato do të rieksportohen me një minimum periudhe shtyrjeje dhe me afat të fundit brenda tre muajve pas mbylljes së ekspozitës. Për arsye të vlefshme, autoritetet doganore mund ta zgjerojnë këtë periudhë brenda kufijve të vendosura nga ligjet dhe rregulloret e shtetit të importimit të përkohshëm.

Neni 5

a) Me gjithë kërkesën e rieksportimit të parashtruar në nenin 4, rieksportimi i mallrave që prishen shpejt, atyre të dëmtuara keqas ose me vlerë të vogël nuk do të kërkohet, me kusht që mallrat:

I) t'u nënshtrohen detyrimeve të importit ndaj të cilave janë përgjegjëse; ose

II) të braktisen pa shpenzime për thesarin e vendit në të cilin ato janë importuar përkohësisht;

III) të shkatërrohen nën mbikëqyrjen zyrtare, pa shpenzime për thesarin e vendit në të cilin ato janë importuar përkohësisht, siç mund të kërkojnë autoritetet doganore. Për më tepër, kërkesat për rieksportim nuk do të zbatohen për mallrat, shkatërrimi i të cilave kërkohet nga Komisioneri i

Përgjithshëm i Seksionit të interesuar, por shkatërrimi duhet të bëhet nën mbikëqyrjen zyrtare dhe pa shpenzime nga thesari i vendit në të cilin ato janë importuar përkohësisht.

b) Mallrat të cilave u është dhënë pranim i përkohshëm, mund të disponohen ndryshe nga rieksportimi dhe veçanërisht mund të merren për përdorim të brendshëm, duke iu nënshtruar pajtueshmërisë me kushtet dhe formalitetet e zbatueshme sipas ligjeve dhe rregulloreve të vendit të importimit të përkohshëm në lidhje me mallra të tilla të importuara drejtpërdrejt nga jashtë.

Neni 6

Produktet e përftuara rastësisht gjatë ekspozimit nga mallrat e importuara përkohësisht, si rrjedhim i demonstrimit të makinerive apo aparaturave, do t'u nënshtrohen dispozitave të neneve 4 dhe 5 të kësaj shtese, në të njëjtën mënyrë sikur atyre t'u ishte dhënë pranim i përkohshëm, duke iu nënshtruar rezervave në nenin 7 më poshtë.

Neni 7

Detyrimet doganore nuk do të vendosen dhe ndalimet dhe kufizimet për import do të hiqen, dhe atje ku do të jepet pranim i përkohshëm, nuk do të kërkohet rieksportim në lidhje me mallrat në vijim, nëse vlera dhe sasia e tyre e përgjithshme, sipas mendimit të autoriteteve doganore të vendit të importimit, janë të arsyeshme duke pasur parasysh natyrën e ekspozitës, numrin e vizitorëve në të dhe shtrirjen e pjesëmarrjes së ekspozuesve:

a) modele të vogla (përveç pijeve alkoolike, mallrave të duhanit dhe lëndëve djegëse), të cilat janë përfaqësuese të mallrave të huaja të shfaqura në ekspozitë, duke përfshirë edhe modele të tilla të ushqimeve dhe pijeve, qofshin të importuara në formën e modeleve të tilla apo të prodhuara në ekspozitë nga materiale ndërtimi të importuara, me kusht që:

I) të sillen pa pagesë nga jashtë vendit dhe të përdoren vetëm për shpërndarje pa pagesë për publikun vizitor në ekspozitë, për përdorim apo konsum individual nga personat të cilëve ato u shpërndahen;

II) të jenë të identifikueshme si modele reklamuese dhe individualisht të jenë me vlerë të vogël;

III) të jenë të papërdorshme për qëllime tregtare dhe të jenë të paketuara, atje ku është e zbatueshme, në sasi shumë më të vogla sesa paketa më e vogël e shitjes me pakicë; dhe

IV) modelet e ushqimeve dhe pijeve që nuk janë shpërndarë të paketuara, siç parashikohet në pikën (iii) më lart, të konsumohen në ekspozitë;

b) modele të importuara të përdorura apo konsumuara nga juritë në ekspozitë gjatë vlerësimit apo gjykimit për artikujt e shfaqur, duke iu nënshtruar paraqitjes së një certifikate nga Komisioneri i Përgjithshëm i Seksionit, ku të përmendet natyra dhe sasia e modeleve të përdorura apo konsumuara në këtë mënyrë;

c) mallra të importuara vetëm për të demonstruar apo për qëllimin e demonstrimit të operimit të një makinerie apo aparature të huaj në ekspozitë dhe të konsumuara apo shkatërruara gjatë demonstrimeve të tilla;

d) printime, katalogë, njoftime tregtare, lista çmimesh, reklama, kalendarë, qoftë të ilustruar apo jo, si edhe fotografi pa kornizë, të cilat janë material i dukshëm publicistik për mallrat e huaja të shfaqura ekspozitë, me kusht që ato të sillen pa pagesë nga jashtë vendit për publikun vizitor në ekspozitë.

Neni 8

Detyrimet doganore nuk do të vendosen dhe ndalimet e kufizimet e importit do të hiqen dhe atje ku do të jepet pranim i përkohshëm, nuk do të kërkohet rieksportim në lidhje me mallrat në vijim:

a) produkte të cilat janë importuar dhe që përdoren në ndërtimin, montimin, zbukurimin, animacionin (gjallërimin), apo furnizimin e stendave të ekspozuesve të huaj në ekspozitë, të tilla si: bojë, llak, letra për veshje muri, pije alkoolike e përpunuar, fishekzjarrë, farëra, bimë etj., të cilat disponohen për përdorimin për të cilin ato janë vendosur;

b) katalogë zyrtarë, fletëpalosje, postera dhe printime të tjera, qoftë apo jo të ilustruara, të cilat

publikohen nga vendet pjesëmarrëse në ekspozitë;

c) plane, skicime, dosje, regjistra, formularë dhe dokumente të tjera që importohen për t'u përdorur si të tilla në ekspozitë.

Neni 9

a) Si në hyrje ashtu edhe në dalje, shqyrtimi dhe miratimi i mallrave të cilat do të ekspozohen apo përdoren, apo të cilat janë ekspozuar apo përdorur në një ekspozitë, do të kryhet, kurdoherë që është e mundur dhe e përshtatshme, në vendin e ekspozimit.

b) Secila Palë Kontraktuese do të bëjë përpjekje, kurdoherë që e çmon të dobishme, duke mbajtur parasysh rëndësinë e ekspozitës, që të hapë për një periudhë të arsyeshme një zyrë doganore në vendin e ekspozitës që mbahet në territorin e saj.

c) Rieksportimi i mallrave të cilat janë importuar përkohësisht mund të bëhet në një apo disa këste dhe përmes cilësdo zyrë doganore e cila është e hapur për këtë qëllim, edhe nëse ajo është e ndryshme nga zyra e importimit, përveçse kur importuesi ka marrë përsipër që të rieksportojë mallrat përmes zyrës së importimit, me qëllim që të përfitojë një procedurë më të thjeshtuar.

Neni 10

Asgjë në këto rregullore nuk do të pengojë zbatimin e:

a) lehtësirave të mëtejshme, të cilat jepen nga Palët Kontraktuese apo mund të jepen nga ato qoftë përmes marrëveshjesh të njëanshme, apo përmes marrëveshjesh shumëpalëshe;

b) rregulloreve, qoftë të brendshme apo të arritura përmes marrëveshjesh, në lidhje me organizimin e ekspozitave të cilat nuk merren me çështje doganore;

c) ndalimeve dhe kufizimeve që rrjedhin nga ligjet dhe rregulloret e brendshme në lidhje me moralin dhe sjelljen publike, sigurinë publike, higjienën apo shëndetin publik, apo me çështje veterinare apo fitopatologjike, apo me mbrojtjen e patentave, markave tregtare, të drejtave të autorit dhe të drejtave të pronësisë intelektuale.

Neni 11

Për qëllime të këtij aneksi, territoret e vendeve kontraktuese të cilat formojnë një bashkim doganor apo ekonomik do të konsiderohen si një territor i vetëm.

Rekomandim

Asambleja e Përgjithshme rekomandon që detyrimet doganore nuk duhet të vendosen dhe ndalimet e kufizimet e importit do të hiqen dhe atje ku do të jepet pranim i përkohshëm, nuk do të kërkohet rieksportim nëse vlera dhe sasia përmbledhëse e tyre është, sipas mendimit të autoriteteve doganore të vendit të importimit, duke marrë parasysh natyrën e ekspozitës, numrin e vizitorëve dhe shtrirjen e pjesëmarrjes së ekspozuesve për produktet e importuara nga Komisionerët e Përgjithshëm të Seksioneve, për:

I) përdorimin e tyre vetjak;

II) përdorimin e tyre gjatë pritjeve zyrtare;

III) ofrimin ndaj vizitorëve VIP të vetë vendit të tyre, vendit mikpritës apo të atyre që vijnë nga një vend tjetër.